



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE I MINIERAVE
DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË



Tiranë, më 15.03.2023

L A J M Ë R I M

Mbi Mbrojtjen e Diplomave dhe Provimin e Formimit për Vitin Akademik 2022 – 2023

SEZONI I VERËS

Rektori i UPT përmes shkresave “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, për Vitin Akademik 2022-2023” (Nr.2041 i Protokollit UPT, datë 19.09.2022), “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, për Vitin Akademik 2022-2023” (Nr.2269 i Protokollit UPT, datë 16.10.2022) dhe “Ndryshime në Strukturën Vjetore të Procesit Mësimor në Semstrin e Dytë të Vitit Akademik 2022-2023” (Nr.559 dhe 559/1 të Protokollit UPT, datë 02.03.2023), ka shpallur Sezonin e Mbrojtjes së Diplomave dhe dhënies së Provimit të Formimit – Sezoni i Verës – Viti Akademik 2022-2023, në periudhën 10.07 ÷ 21.07.2023.

Në datën **19.07.2023**, në Departamentin e Burimeve të Energjisë (Zyra e DBE, Nr. 405) **DO TË ORGANIZOHET MBROJTJA E DIPLOMAVE¹** për Programet e Studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në diplomat që administrohen nga Departamenti i Burimeve të Energjisë.

Lajmërohen të gjithë studentët e Diplomave të mësipërme, të cilët kanë rregjistruar temat pranë DBE, si edhe kanë kaluar me sukses kontrollet përkatëse, **SE DATA E FUNDIT E DORËZIMIT TË MATERIALEVE DO TË JETË 07.07.2023, ORA 12⁰⁰**. Studentët duhet të dorëzojnë:

1. Temën e Diplomës në variant të printuar (të strukturuar sipas kërkesave të udhëzimit mbi Temën e Diplomës dhe të nënshkruar nga udhëheqësi përkatës);
2. Temën e Diplomës në variant elektronik (CD/DVD);
3. Prezantimin në ppt. (CD/DVD).

Lajmërohen të gjithë studentët e Diplomës Bachelor në “Inxhinierinë e e Naftës dhe Gazit” dhe Master Profesional në “Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit”, **SE DATA E PROVIMIT TË FORMIMIT DO TË JETË 17.07.2023 – AUDITORI NR.402 (BACHELOR)/AUDITORI NR.403 (MASTER PROFESIONAL) – DBE, ORA 09⁰⁰**.

Programet e shkurtuara, metodologjinë e vlerësimit si edhe pyetjet mund ti gjeni pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë.

¹ Orari do t’ju bëhet i ditur me shkresë më vete